



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 323 prot.

Tiranë, më 22.02.2019

VENDIM
Nr.15, datë 22.02.2019

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR.16, DATË 23.03.2018, NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË URA VAJGURE

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 16, datë 23.03.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Ura Vajgurore dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

KONSTATOVA SE:

Bazuar në Urdhrin nr. 75 (749 prot.), datë 03/10/2018, “Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 16, datë 23.03.2018, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Ura Vajgurore.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me Vendimin Nr. 2, datë 13.01.2017, nëpërmjet Vendimit Nr. 93, datë 25.04.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Ura Vajguore”, Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Ura Vajguore.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Ura Vajguore raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr.16, datë 23.03.2018, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës dhe një afat prej 60 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport, në detyrat e lëna për Bashkinë Ura Vajguore, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë dhe pas verifikimit në subjekt të veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatoj se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

➤ Në vendimin paralajmërues të Komisionerit, konkretisht ***në pikën 2 të tij***, është lënë detyrë që të konstatohet pavlefshmëria absolute për **5** raste emërimi në kundërshtim me ligjin dhe të hartohet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për vitin 2018.

Ngashqyrtimi i dokumentacionit të administruar, vërej se në lidhje me pozicionet e punës të plotësuara në kundërshtim me ligjin janë zhvilluar procedurat e konkurrimit, nga ku rezulton se:

Me shkresat nr. 2192 prot., datë 22.09.2017; nr. 2191 prot., datë 22.09.2017; nr. 1053 prot., datë 21.05.2018; nr. 2246 prot., datë 02.10.2017 dhe nr. 1052 prot., datë 21.05.2018, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Ura Vajguore ka bërë shpalljen e 5 pozicioneve të lira të punës dhe konkretisht: “*Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Sporteve*”, “*Specialist Topograf në Drejtorinë e Urbanistikës*”, “*Inspektor i Taksave*”, “*Specialiste e Financave*” dhe “*Specialist Veteriner*”.

Nga këqyrja e akteve që materializojnë procedurat e konkurrimit për këto 5 raste, konstatoj se njësia përgjegjëse ka zbatuar procedurat e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe

të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave.

Njësia përgjegjëse ka publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Ura Vajgurore, në standat e njoftimeve për publikun dhe në Shërbimin Kombëtar të Punësimit aktet si më poshtë vijojnë:

- a) Aktet e shpalljes për plotësim, për çdo pozicion të lirë të punës në shërbimin civil, në të cilat ishin përcaktuar qartë (*përshkrimi përgjithësues i pozicionit të punës; pranimi në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (arsimi i lartë përkatës); dokumentacioni i nevojshëm, mënyra dhe procedura e paraqitjes së kandidaturave; data për paraqitjen e aplikimit; data e zhvillimit të konkurrimit; data për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyra e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyra e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët*).
- b) Aktet e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*”, ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”, etj.

Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, janë shpallur fitues dhe më tej janë emëruar në detyrë sipas akteve përkatëse, punonjësit si më poshtë:

1. *****, emëruar me aktin nr. 2192/17 datë 01.12.2017, në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Sporteve*”;
2. *****, emëruar me aktin nr. 2191/18 datë 01.12.2017, në pozicionin “*Specialist Topograf në Drejtorinë e Urbanistikës*”;
3. *****, emëruar me aktin nr. 1053/19 prot., datë 18.07.2018, në pozicionin “*Inspektor i Taksave*”;
4. *****, emëruar me aktin nr. 2246/17 datë 11.12.2017, në pozicionin “*Specialiste e Financave*”;
5. *****, emëruar me aktin nr. 1052/17 prot., datë 18.07.2018, në pozicionin “*Specialist Veteriner*”.

Më tej, në zbatim të rekomandimeve të lëna në vendimin paralajmërues, njësia përgjegjëse, me Vendimin nr. 147, datë 24.01.2018, “*Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2018*”, ka hartuar planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2018.

Në analizë të sa më sipër, konstatohet se wshtw rikthyer gjendja e ligjshmërisë, përmes realizimit të procedurave të konkurrimit në përputhje me ligjin për shërbimin civil, kjo pikë e vendimit paralajmërues do të konsiderohet si e përmbushur.

➤ Në **pikën 3 dhe 4** të vendimit të Komisionerit i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që, në bashkëpunim me subjektet e tjera të ngarkuara nga ligji, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës dhe vlerësimeve për të gjitha pozicionet e shërbimit civil.

Nga dokumentacioni i administruar në institucionin e mbikëqyrurvërej se, janë hartuar përshkrimete punës dhe janë kryer vlerësimet për çdo nëpunës civil, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto dy institute të ligjit.

➤ Në **pikën 5** të vendimit paralajmërues, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të plotësojë të gjitha mangësitë e konstatuara në dosjet e personelit të evidentuara në anekset bashkëlidhur raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Bazuar në përmbajtjen e Aktit të Konstatimit, vërej se, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Ura Vajguore ka plotësuar të gjitha dosjet e nëpunësve sipas Lidhjes 1 dhe 2 bashkëlidhur Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, si dhe të gjitha mangësitë e konstatuara në anekset pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se, nga ana e njësisë përgjegjëse janë marrë të gjitha masat për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 16, datë 23.03.2018, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Ura Vajguore dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Ura Vajgurore, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 16, datë 23.03.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Ura Vajgurore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha